




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova /
Ministry of Internal Affairs

INSTITUTI I KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE
INSTITUT KOSOVA ZA JAVNU ADMINISTRACIJU
KOSOVO INSTITUTE FOR PUBLIC ADMINISTRATION



Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) në bazë të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 13/2018 për Kushtet, Angazhimin, Kategorizimin dhe Mënyrën e Pagesës së Trajnerëve në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, shpall:

THIRRJE PËR APLIKIM

Ftohen të interesuarit të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi për trajnimin e trajnerëve, të aplikojnë për trajnerë të ardhshëm për zbatim të këtij programi:

Trajnimi i Trajnerëve për Sistemet e Financave

Qëllimi i trajnimit është të certifikojë trajnerë të kualifikuar për sistemet financiare digjitale, të cilët në të ardhmen do të mbajnë trajnime për aplikimin e këtyre sistemeve në sektorin publik. Ky trajnim synon të përgatisë profesionistë që të kontribuojnë në digjitalizimin dhe përmirësimin e shërbimeve financiare në administratën publike. Ky trajnim synon të forcojë aftësitë teknike dhe metodologjike të kandidatëve për zbatimin dhe menaxhimin e sistemeve të financave.

Ky program do të përfshijë një kombinim të trajnimit teknik dhe metodave efektive për zhvillimin e shkathtësive trajnimi në fushën e sistemeve të financave. Trajnimi do të fokusohet në sistemet që shërbejnë për digjitalizimin e shërbimeve financiare, me qëllim që të zhvillohen trajnerë të kualifikuar për të ndihmuar në zbatimin e këtyre sistemeve brenda sektorit publik.

Kohëzgjatja dhe koha e mbajtjes së programit të trajnimit

Trajnimi për Trajnerë TpT pritet të mbahet gjatë muajit nëntor 2024

Vlerësimi i kandidatëve:

Në harmoni me Udhëzimin Administrativ të lartcekur, të gjithë kandidatët për trajnerë do të vlerësohen gjatë periudhës dhe pas përfundimit të trajnimit.

Aplikacionet vlerësohen në bazë të kriterëve si në vijim:

- Arsimimi dhe kualifikimi profesional;
- Përvoja e punës (së paku 5 vite përvojë pune profesionale);
- Përvoja në trajnime;
- Elementet tjera të meritës (publikime në fushën e legjislacionit, pjesëmarrja në hartimin e legjislacionit, certifikatat);

Angazhimi i trajnerëve pas trajnimit:

Aplikantët e suksesshëm do të angazhohen si trajner sipas nevojave të programit specifik të trajnimit për sistemet e financave nga IKAP

Afati kohor për dorëzimin e aplikacioneve: 31.10.2024 deri me 14.11.2024.

Numri i kandidatëve që do të përzgjidhen për të vijuar trajnimin është i limituar.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm **CV (formati Europass)** dhe një **letër motivimi** (deri në **250 fjalë**) në mënyrë elektronike në gjuhën shqipe.

Aplikimi bëhet në mënyrë elektronike në e-mail adresën: besart.mulaj@rks-gov.net, duke specifikuar emërtimin e programit për të cilin aplikojnë.

Të gjitha kualifikimet dhe dëshmitë e përmendura në CV tuaj mund të kërkohen për verifikim.